


EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6561
E enjte, 17 mars 2022
çmimi 0.40 €

Vazhdon 'fshesa' e ministres Gërvalla



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

MBROJTJA: GUCATI DHE HARADINAJ JANË TË PAFAJSHËM



Në ditën e dytë të paraqitjes së deklaratës përmbyllëse nga mbrojtja në gjykimin ndaj kryetarit të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Hysni Gucati dhe nënkryetarit Nasim Haradinaj, është theksuar nga avokatët mbrojtës se klientët e tyre janë të pafajshëm. Avokatët mbrojtës kanë pohuar se kanë besim se trupi gjykues do t'i zbatojë parimet bazë për provat dhe do t'i trajtojë në mënyrë të drejtë dhe të barabartë. Sipas tyre, në deklaratën e vet mbyllëse prokuroria pati një qasje shumë agresive


AKTUALE



KËSHILLI I EVROPËS ZYRTARISHT E PËRJASHTON RUSINË F. 2

LV-ja DHE AAK-ja SHPALLIN ZGJEDHJET E BRENDSHME F. 3

ARMË, MUNICION DHE PARA KONFISKOHEN NË AKSIONIN "BREZOVICA" F. 7



EKONOMI



PËR DHE KUNDËR TËRHEQJES SË PARAVE NGA TRUSTI F. 8

SPORT



DUKA, PAS RIZGJEDHJES KRYETAR I FSHF-SË: DUA T'I LË PAS TË GJITHA SHPIFJET DHE OFENDIMET F. 10

95.1 për qind e qytetarëve të Kosovës janë pro anëtarësimit në NATO



LIDERËT E EVROPËS QENDRORE LAVDËROJNË 'LUFTËN E GUXIMSHME' TË UKRAINËS

FAQE 4-5

RENOVA
PUTZ
Mqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Këshilli i Evropës zyrtarisht e përjashton Rusinë

STRASBURG, 16 MARS - Këshilli i Evropës tha se Komiteti i Ministrave zyrtarisht ka vendosur ta përjashtojë Rusinë nga ky trup për të drejtat e njeriut.

Kjo është hera e parë që një anëtar përjashtohet nga ky Këshill.

Këshilli i Evropës, me seli në Strasburg, tha përmes një deklarate më 16 mars se ka

miratuar në mënyrë unanime mocionin "që thotë se Federata Ruse më nuk mund të jetë anëtare e organizatës".

Ky vendim vjen pasi Rusia kishte njoftuar organizatën se do të tërhiqej, duke shtuar se "Federata Ruse pushon së qeni anëtare e Këshillit të Evropës nga sot, pas 26 vjetësh anëtare".

Këshilli i Evropës e kishte pezulluar pjesëmarrjen e Rosisë

më 25 shkurt, një ditë pasi Moskani nisi pushtimin e paprovokuar të Ukrainës.

Sekretarja e përgjithshme e Këshillit të Evropës, Marija Pejcinovic Buric, e ka përshkruar sulmin ndaj Ukrainës si "shkelje flagrante" e statusit të Këshillit të Evropës dhe të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, institucion të cilin Këshilli e mbikëqyrë.



Liderët e Evropës Qendrore lavdërojnë "luftën e guximshme" të Ukrainës

KIEV, 16 MARS - Udhëheqësit e tri vendeve të Evropës Qendrore e kanë lavdëruar Ukrainën për "luftën e saj të guximshme" kundër forcave pushtuese ruse, pasi kanë përfunduar një udhëtim në Kiev në shenjë solidariteti me qytetin e rrethuar dhe presidentin e Ukrainës, Volodymyr Zelensky.

Vaclav Smolka, zëdhënës i kryeministrit çek, Petr Fiala, postoi në "Twitter" një foto të kryeministrit çek më 16 mars, me një jelek mbrojtës dhe me helmetë.

Petr Fiala dhe kryeministrat e Polonisë dhe Sllovenisë shkuan në Kiev një ditë më parë për të

parë nga afër shkatërrimin dhe për t'u takuar me presidentin ukrainas Volodymyr Zelensky. Kjo ishte vizita e parë në qytet nga udhëheqës të huaj që nga fillimi i pushtimit rus më 24 shkurt.

"Këtu, në Kiev in e shkatërruar nga lufta, historia po bëhet", ka shkruar kryeministri polak Mateusz Morawiecki në "Twitter", duke postuar një foto së bashku me kryeministrin çek dhe atë slloven në një tryezë me Zelenskyn dhe zyrtarë të tjerë bashkë me një hartë të Ukrainës.

"Kjo luftë është rezultat i tiranit mizor që sulmon civilët e pambrojtur, duke bombarduar



qytetet dhe spitale në Ukrainë. Si pasojë e kësaj lufte, bota humbi ndjenjën e sigurisë dhe njerëzit e pafajshëm po vdesin. Duhet ta

ndalim këtë tragedi, që po ndodh në lindje, sa më shpejt që është e mundur", ka shkruar Morawiecki.

Kryeministri çek, Petr Fiala, vlerësoi "luftën e guximshme" të Ukrainës për ta kundërshtuar pushtimin rus. "Ju po luftoni për jetën tuaj, vendin tuaj dhe lirinë tuaj. Ne e dimë se po luftoni edhe për jetët tona. Nuk jeni vetëm", ka shkruar ai në "Twitter".

Kryeministri slloven Janez Jansa tha se "kuptuam se vlerat themelore evropiane ekzistojnë në të vërtetë dhe janë të kërcënuara dhe se evropianët po i mbrojnë ato me jetën e tyre në Ukrainë".

Zelensky e përshkroi vizitën si një hap të madh dhe të guximshëm.

Ukraina refuzon propozimet ruse për neutralitet

KIEV, 16 MARS - Ukraina ka njoftuar të mërkurën se dëshiron që siguria e saj të garantohej nga forcat ndërkombëtare dhe hodhi poshtë propozimet e Rosisë që ajo të miratojë një status neutral të krahasueshëm me Austrinë ose Suedinë. "Ukraina është tani në një gjendje lufte me Rusinë. Si rezultat, modeli mund të jetë vetëm 'ukrainas' dhe vetëm me garanci sigurie të verifikuara ligjërisht", ka bërë



me dije kryenegociatori i Ukrainës, Mikhaïlo Podolyak, në komentet e publikuara nga zyra e presidentit ukrainas

Volodymyr Zelensky. Ai bëri thirrje për një marrëveshje sigurie ligjërisht të detyrueshme, të nënshkruar nga partnerët ndërkombëtarë, të cilët "nuk do të qëndrojnë mënjanë në rast të një sulmi ndaj Ukrainës siç bëjnë sot". Kremlini tha më herët të mërkurën se një Ukrainë neutrale ngjashëm si Suedia ose Austria po diskutohej në bisedimet me Kievin për t'u dhënë fund luftimeve 3-javore

në Ukrainë. "Ky është një opsion që po diskutohet tani dhe që mund të konsiderohet si një kompromis", u tha gazetarëve zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov. Komentet e tij pasuan deklaratat e ministrit të Jashtëm, Sergei Lavrov, se neutraliteti ishte në qendër të bisedimeve. Suedia zyrtarisht është e paangazhuar ushtarakisht në kohë paqeje dhe neutrale në kohë lufte, pasi i dha fund

politikës së saj të neutralitetit në vitin 1992 në fund të Luftës së Ftohtë.

Ajo nuk është anëtare e NATO-s, por ka qenë partnere e aleancës për gati 30 vjet.

Në fund të Luftës së Ftohtë, Suedia uli shpenzimet e saj ushtarake, por filloi të riinvestojë në mbrojtjen e saj pas aneksimit nga Rusia të gadishullit të Krimesë më 2014. Rusia dhe Ukraina kanë zhvilluar disa raunde negociatash.

Kryeministri britanik: Ukraina nuk do të anëtarësohet së shpejti në NATO

LONDËR, 16 MARS - Kryeministri britanik, Boris Johnson, tha të mërkurën se "nuk ka asnjë mundësi që Ukraina të bashkohet me NATO-n së shpejti".

Johnson tha se e kupton presidentin ukrainas, Volodymyr Zelensky, i cili të martën në një video-telefonatë me të dhe përfaqësues të vendeve të tjera në Forcën e Përbashkët të Ekspeditës, shprehur zhgënjimin e tij që Ukraina nuk ishte lejuar të anëtarësohej në NATO. "Kjo është e vërteta dhe ne thjesht

duhet ta pranojmë ashtu siç është. Kam biseduar me Volodymyr Zelenskyn përsëri dje (të martën) dhe sigurisht e kuptoj atë që ai po thotë për NATO-n. Dhe, të gjithë kanë thënë gjithmonë dhe ne e kemi bërë të qartë edhe për Putinin se nuk ka asnjë mënyrë që Ukraina të bashkohet me NATO-n së shpejti", ka shtuar Johnson.

Kryeministri britanik tha se vendimet në lidhje me të ardhmen e Ukrainës duhet të merren nga populli ukrainas dhe udhëheqësi i tyre", dhe u zotua se Britania do të vazhdojë



ta "mbështesë" Zelenskyn. "Gjëja më e rëndësishme është se agresioni i Putinit, sulmet e tij

absolutisht barbare ndaj Ukrainës, duhet të ndalen", shtoi kryeministri Johnson.

Përmes një video-lidhjeje, Zelensky tha të martën se "NATO-ja është aleanca më e fortë në botë, por disa nga anëtarët e kësaj aleance janë të hipnotizuar nga agresioni rus".

Rusia ka nisur pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt dhe Zelensky ka kërkuar disa herë nga NATO-ja që ta vendosë zonën e ndalim-fluturimit mbi Ukrainë.

NATO-ja ka refuzuar, duke thënë se një veprim i tillë do të mund ta përshkallëzonte konfliktin në përmasat e një lufte të tretë botërore.

95.1 për qind e qytetarëve të Kosovës janë pro anëtarësimit në NATO

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 16 MARS - UBO Consulting ka kryer një hulumtim në Kosovë ku qytetarët janë pyetur rreth temave të ndryshme që shqetësojnë vendin.

OMNIBUS është një matje që bëhet me 1 065 qytetarë, ku institucionet, organizatat dhe bizneset mund t'i vendosin pyetjet e tyre për ta kuptuar qëndrimin e opinionit publik lidhur me një temë të caktuar.

UBO Consulting, marrë parasysh zhvillimet e fundit në botë, rajon dhe vend, ka vendosur që të bëjë disa pyetje aktuale për ta parë disponimin e opinionit lidhur me temat e ndryshme.

Duket se vazhdon të ekzistojë një disponim i lartë i qytetarëve për anëtarësim në NATO dhe BE. "95.1 për qind e të anketuarve në pyetjen 'A duhet të anëtarësohet Kosova në NATO' janë përgjigjur me po, 4 për qind jo, ndërsa 0.9 për qind 'Nuk e di'. Ngjashëm, në pyetjen se 'A duhet të anëtarësohet Kosova në BE', 93.9 për qind e qytetarëve janë përgjigjur po, 5.2

për qind jo dhe 0.9 për qind nuk e di", ka njoftuar UBO Consulting.

Në këtë pyetësor janë pyetur qytetarët e të gjitha etnive.

Të shqiptarët 99.4 për qind janë përgjigjur pro anëtarësimit në NATO, 0.4 për qind kundër dhe 0.2 për qind "nuk e di".

Ndërsa serbët asnjë nuk është përgjigjur për, 86 për qind kundër dhe 14 për qind "nuk e di".

Minoritetet e tjera janë përgjigjur 90.7 për qind për anëtarësimin në NATO, 4.7 për qind kundër dhe 4.7 për qind nuk e di. "Për pyetjen e anëtarësimit në BE, sipas etnive, shqiptarët janë përgjigjur me 98.3 për qind pro anëtarësimit, 1.5 për qind kundër dhe 0.2 për qind kanë abstenuar. Serbët janë përgjigjur në mënyrë identike si për anëtarësimin në NATO, asnjë nuk është përgjigjur pro anëtarësimit në BE, 86 për qind kundër dhe 14 për qind nuk e di. Ndërkaq minoritetet e tjera janë përgjigjur 90.5 për qind pro anëtarësimit në BE, 7.1 për qind kundër dhe 2.4 për qind nuk e di", ka njoftuar UBO Consulting.

Përzgjedhja e amvisërisë, duke shfrytëzuar metodën sistematike



të rastësisë, si dhe zhvillimi i anketës me personin i cili e ka ditëlindjen e parë më të afërt i moshës mbi 18 vjet. Pyetësori

është realizuar me 1 065 të anketuar.

Pyetësori është realizuar nga data 7 mars deri më 15 mars 2022 në 38

komuna të Kosovës dhe ka nivel të besueshmërisë prej 95-përqindësh me marzhë të gabimit prej +3 pikë të përqindjes.

LV-ja dhe AAK-ja shpallin zgjedhjet e brendshme

EPOKA
ERE

Q. RAMA

PRISHTINË, 16 MARS - Lëvizja Vetëvendosje (LV) ka shpallur zgjedhjet e brendshme të përgjithshme. Sipas LV-së, nga 15 marsi secili anëtar i kësaj partie do të ketë të drejtë të votojë e të kandidohet.

"Lëvizja Vetëvendosje është organizata me mbështetjen më të madhe në vend, çka duhet të reflektohet në struktura edhe më të fuqishme, e të cilat do të vijnë si rezultat i zgjedhjeve që do të jenë të drejtpërdrejta, të lira e demokratike. Në 30 qendra të LV-së në Kosovë anëtarët e saj do të kenë mundësi që përmes parimit 'një anëtar, një votë' t'i zgjedhin kryesitë e kryetarët e pikave nëpër lagje e fshatra, t'i propozojnë kandidatët që vlerësojnë më së shumti apo edhe të vetëpropozohen", është thënë në njoftimin e LV-së, e cila i ka ftuar të

gjithë anëtarët që të bashkohen në këtë proces zgjedhor.

Edhe partia e Ramush Haradinajt, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), ka vendosur për datën e procesit të brendshëm zgjedhor. Sipas një njoftimi nga kjo parti, është bërë me dije se në javën e parë të qershorit do të mbahet Kuvendi Qendror i AAK-së. "Në takimin e mbajtur në Selinë e Aleancës, për të diskutuar rreth zgjedhjeve të brendshme partiake, Këshilli Drejtues ka miratuar numrin e delegatëve që do t'i përfaqësojnë degët e AAK-së në Kuvendin Qendror. Gjithashtu, Këshilli Drejtues ka vendosur që data e mbajtjes së Kuvendit të jetë në javën e parë të qershorit 2022, kur dhe pritet që të përmbyllet të gjitha kuvendet e degëve të AAK-së. Kryetari Haradinaj ka vlerësuar lart angazhimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues dhe ka uruar sukses në zgjedhjet e radhës", ka njoftuar AAK-ja.

Gazetarët bëhen përfitues të ndihmës juridike falas

PRISHTINË, 16 MARS (ER) - Gazetarët, fotoreporterët, kameramanët dhe redaktorët për herë të parë janë përfshirë si kategori përfituese në Ligjin për Ndihmë Juridike Falas, të miratuar në Kuvendin e Kosovës më 25 shkurt 2022.

Kyndryshim ligjor nënkupton që nëse gazetarët largohen nga puna, paditen për shpifje,

ballafaqohen me Padi Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike (SLAPP) apo ndiqen penalisht, ata do të përfitojnë shërbime falas juridike dhe përfaqësim në gjykatë nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas.

Ndryshimi ligjor është propozuar nga juristja e së drejtës së medias, Flutura Kusari dhe Asociacioni i Gazetarëve të

Kosovës dhe është mbështetur nga shumica e partive politike në pushtet dhe në opozitë.

Përfitues mund të jenë vetëm ata që punojnë në radio dhe televizione të licencuara nga Komisioni i Pavarur për Media dhe/apo ata që punojnë në mediet online që janë të regjistruara në Këshillin e Medieve të Shkruara të Kosovës.





Mbrojtja: Gucati dhe Haradinaj janë të pafajshëm

Në ditën e dytë të paraqitjes së deklaratës përmbyllëse nga mbrojtja në gjykimin ndaj kryetarit të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Hysni Gucati dhe nënkryetarit Nasim Haradinaj, është theksuar nga avokatët mbrojtës se klientët e tyre janë të pafajshëm. Avokatët mbrojtës kanë pohuar se kanë besim se trupi gjykues do t'i zbatojë parimet bazë për provat dhe do t'i trajtojë në mënyrë të drejtë dhe të barabartë. Sipas tyre, në deklaratën e vet mbyllëse prokuroria pati një qasje shumë agresive

PRISHTINË, 16 MARS - Në Gjykatën Speciale në Hagë ka vazhduar edhe të mërkurën paraqitja e deklaratës përmbyllëse nga mbrojtja në gjykimin ndaj kryetarit të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Hysni Gucati dhe nënkryetarit Nasim Haradinaj.

Avokati Jonathan Elystan Rees, që mbron Hysni Gucatin, ka vazhduar dhënien e deklaratës së tij përmbyllëse. Ai ka thënë se ky i fundit është i pafajshëm dhe se synimi i tij ishte për ta zbuluar nivelin e bashkëpunimit në mes të Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS) dhe Serbisë dhe se prokuroria, siç thotë i akuzuari, është e njëanshme.

Avokati ka theksuar se nuk është paraqitur asnjë provë se ka pasur ndonjë kanosje të drejtpërdrejtë. Sipas tij, Gucati ka bërë vetëm një koment dhe ka pranuar se nuk ka pasur qëllim ta përdorte forcën.

Avokati Jonathan Elystan Rees ka thënë se në rreshtin 22 deri në 29 tregohet diskutimi i Gucati me një

gazetar në mes të diskutimit. "Gazetari thotë kush do të marrë përgjegjësinë dhe Gucati thotë se ne nuk i kemi nxjerrë këta emra dhe nuk e dimë nga ku, por ky material na ka ardhur në zyrë, ne nuk kemi bërë asgjë dhe nuk punojmë për Gjykatën Speciale. Pranimi që mund të ndodhin gjëra as nuk i afrohet pohimit të faktit se Gucati ka pasur ndonjë qëllim", ka theksuar Elystan Rees.

Ai ka thënë se nuk ka pasur synime me qëllim të këqija dhe se nuk ka dëshiruar të dëmtohet asnjë person. "Synimi i deklaruar i Gucati ka qenë ta ekspozojë bashkëpunimin që ka ekzistuar mes ZPS-së dhe Serbisë. Gjatë gjithë kohës të aktakuzës ka hedhur poshtë të gjitha akuzat që synimi i tij ka qenë për t'i frikësuar dëshmitarët dhe e ka cilësuar si klishe dhe referim të pabazë", ka thënë ai.

Më tutje, ai ka treguar se Haradinaj në prani të Gucati, në konferencën e tretë të shtypit, ka thënë se synimi i tyre nuk është

për t'i mbuluar këto krime nëse të njëjtat kanë ndodhur apo për ta mbrojtur dikë që është kriminel. Kurse ka thënë se Gucati në dëshminë e tij ka thënë se asnjëherë nuk ka menduar se po kërcënon ndonjë person dhe se nuk ka kërcënuar asnjëherë dikë në jetën e tij.

Sipas avokatit, Gucati ka thënë se armiq i quan ata që kanë protestuar më 1999 kur bënte sulme ajrore kundër Serbisë dhe për të ata janë armiq të tij dhe vendit të tij. "Gucati ka thënë se mund të jesh armik i Kosovës dhe të jesh dëshmitar dhe kemi parë shembuj, por kjo nuk do të thotë që çdo dëshmitar është edhe armik. Siç e thashë më herët, frikësimi apo efekti si pasojë apo synim nuk mjafton", ka thënë ai.

Gjithashtu, avokati tha se Gucati ka thënë se nuk kanë nxjerrë asnjë emër dhe nuk ka arsye të jenë të dëmtuar të njëjtët. Sipas tij, nga ana tjetër prokuroria në dosjen e vet përfundimtare thotë se i akuzuari ka shkaktuar frikë dhe ka

dërguar në humbjen e besimit të dëshmitarëve. "Sa i takon synimit specifik, duhet të jetë i tillë që të shkaktojë dëmtim dhe dërgojë në hakmarrje për dhënie të informacionit të vërtetë, nëse informacioni është i rremë apo beson se informacioni është i rremë atëherë nuk kemi të bëjmë me vepër penale", tha ai. Sipas tij, nuk mjafton që i pandehuri të mendojë se informacioni i dhënë nga dëshmitari mund të ketë qenë i vërtetë siç pretendon prokuroria. "Gucati nuk ka vendosur synimin e vet më lart se kaq që informacioni mund të ketë qenë i vërtetë. Nuk mjafton që vepra të ketë synim të drejtpërdrejtë. Prokuroria duhet të vërtetojë të paktën përtej dyshimit të arsyeshëm që kryesuesi ka dhënë informacion të vërtetë. Duhet të jetë përtej dyshimit të arsyeshëm që informacioni që ka dhënë dëshmitari të jetë i vërtetë dhe këtë nuk e ka bërë prokuroria", ka thënë ai.

Ndërkaq në fjalën e tij përmbyllëse, avokati i Nasim Haradinajt, Toby Cadman, ka thënë se klienti i tij ka vepruar gjithmonë në interesin publik dhe se ky ka qenë parimi që ka udhëzuar gjithmonë atë.

Cadman ka thënë se Haradinaj është kritikuar se ka thënë atë që beson dhe mendon se është e vërtetë. Sipas tij, ka mungesë të

plotë provash për t'i vërtetuar pretendimet kundër tij dhe se ka pasur të meta në nxjerrjen e dokumenteve dhe nuk kanë pasur dokumentet që duhen dhe, siç thotë prokuroria, ato përbëjnë bazën e dënimit për të.

Avokati Cadman ka thënë se mbështet thëniet e avokatit të Gucati dhe se vlejnë edhe për Haradinajn të njëjtat dhe nuk do t'i përsërisë ato. Sipas tij, ka plot gjëra sa i përket ligjit dhe provave që janë njësoj të zbatueshme për të dy të akuzuarit. "Së pari që në fillim zoti Rees tha se ky është një rast kur prokuroria duhet të vërtetojë përtej dyshimit të arsyeshëm dhe edhe unë e ngre këtë pikë dhe kjo barrë i takon prokurorisë. Në rastin e Haradinajt apo të ndonjë të akuzuari tjetër, nuk u takon atyre ta vërtetojnë pafajësinë e tyre, por i takon prokurorisë t'i vërtetojë të gjitha pikat e aktakuzës. Kjo është përgjegjësi shumë serioze", ka thënë avokati Cadman.

Ai ka thënë se trupi gjykues i ka parasysh detyrimet e prokurorisë, por janë pika të arsyeshme që ai duhet t'i paraqesë. "Unë kam besim të plotë siç ka edhe Haradinaj që trupi gjykues do t'i zbatojë parimet bazë për provat dhe do t'i trajtojë në mënyrë të drejtë dhe të barabartë. Në deklaratën e vet mbyllëse, prokuroria pati një qasje shumë

“Bashkësia civile” ndez debatin në Kuvend

PRISHTINE, 16 MARS - Diskutimi për Projektkodin Civil, i cili ka nisur në seancën e Kuvendit të Kosovës të mërkurën, pas paraqitjes së shkurtër të materies së këtij Projektodi nga ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, është përcjell me debate nga deputetët e Kuvendit.

Debati është përqendruar te materia e Projektkodit Civil që definojnë martesën ndërmjet personave me gjini të ndryshme, në veçanti për Nenin 1138, paragrafin 2, i cili parashihet “bashkësitë e regjistruara civile me seks të njëjtë”.

Ky është leximi i parë i Projektkodit Civil në Kuvendin e Kosovës.

Mimoza Kusari-Lila, shefe e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje, ka theksuar se Projektodi Civil ka rregulluar vetëm martesën e personave me gjini të ndryshme. “Përderisa Draftodi Civil nuk e rregullon martesën e personave me gjini të

njëjtë, por vetëm në mënyrë afirmative e njeh ‘bashkësinë civile’, duke referuar që në të ardhmen duhet të nxirret një ligj i veçantë, i cili cakton kushtet dhe procedurën e martesës në mes të personave të gjinisë së njëjtë”, ka thënë Kusari-Lila.

Abelard Tahiri, shef i grupit parlamentar i partisë më të madhe opozitare, Partisë Demokratike të Kosovës, gjatë seancës ka thënë se lidhur me Projektkodin Civil, në veçanti për “bashkësitë civile” ndërmjet gjinive të njëjta, patën reaguar bashkësitë fetare në Kosovë. “Ky ka qenë një debat i gjatë në republikën tonë dhe neve na intereson mendimi i kryeministrit për këtë çështje, sepse nuk është prononcuar asnjëherë”, tha Tahiri. Driton Selmanaj nga Lidhja Demokratike e Kosovës ka deklaruar se fokusi në çështjen e definimit të martesës dhe “bashkësisë civile” ka lënë anash shumë çështje të tjera të

rëndësishme që rregullon materia e Projektkodit Civil. “Nëse qëndrimi i qeverisë është ashtu siç e ka artikulluar në Projektkod, që ‘bashkësitë civile’ të njihen si kategori tash e tutje dhe të përcaktohen me ligj të veçantë, atëherë a ka bërë punë Qeveria e Kosovës që ta kemi një ligj të veçantë dhe në çfarë faze është kjo. Nëse është dashur që vetëm në mënyrë afirmative ta sjellim këtu... Por, në Kushtetutë është kjo sjellje afirmative. Pse është dashur që në Kodin Civil të ripërsëritet kjo qasje afirmative?”, ka pyetur Selmanaj. Besnik Tahiri, shef i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, ka thënë se qytetarëve duhet thënë troç mendimin lidhur me “bashkësitë civile”. “Ne e kemi diskutuar këtë çështje në detaje dhe si grup parlamentar jemi deklaruar para tri javësh se jemi kundër versionit të këtij Kodi Civil”, ka deklaruar Tahiri.

Erxhan Galushi, i cili ka prezantuar

qëndrimin e grupit parlamentar multietnik, theksoi se Projektkodit Civil i janë shtuar risi të reja, sidomos pjesa e materies që trajton martesën, për të cilat ky grup parlamentar konsideron që janë kundër vlerave dhe traditave familjare dhe të vendit. “Unë mendoj që e jashtëzakonshme nuk mund të jetë kurrë e zakonshme, ashtu sikurse panatyrshmëria nuk mund të jetë kurrë e natyrshme. Publikimi dhe promovimi i të jashtëzakonshmes në diçka të zakonshme mendojmë se është fyerje për shumicën e zakonshme”, ka theksuar Galushi. Në Projektkodin Civil thuhet se “martesa është bashkësi e regjistruar ligjërisht ndërmjet dy bashkëshortëve të seksëve të ndryshme, me anë të së cilës ata lirshëm vendosin që të jetojnë së bashku si burrë e grua”.

Por, në nenin e radhës thuhet se “bashkësitë e regjistruara civile ndërmjet personave me seks të njëjta janë të lejuara” dhe se

kushtet dhe procedura lidhur me këtë rregullohen me ligj të veçantë. Në Kushtetutën e Kosovës thuhet “se në bazë të pëlqimit të lirë çdokush gëzon të drejtën të martohet dhe të drejtën që të krijojë familje në pajtim me ligjin”. Në Projektkodin Civil nuk definohet se çfarë është “bashkësi civile”. Por, megjithatë, aty shkruan se “të martuarit dhe partnerët në bashkësi civile gëzojnë të drejta dhe detyra reciproke në bazë të këtij Kodi”. Në vendet perëndimore bashkësitë civile nuk konsiderohen si martesa, por si marrëdhënie e ligjshme ndërmjet dy personave, që sigurojnë mbrojtje ligjore për çiftin vetëm në nivel shtetëror. Në Bashkimin Evropian bashkësitë civile lejojnë dy persona që jetojnë së bashku në çift, ta regjistrojnë marrëdhënien e tyre me autoritetin publik përkatës në vendbanimin e tyre. Dallimet midis vendeve të BE-së në këtë fushë po ashtu ekzistojnë.



Kurti: Kodi nuk rregullon martesat mes gjinisë së njëjtë

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, duke iu drejtuar deputetëve të Kuvendit, ka thënë se “regjistrimi i ‘bashkësive civile’ të personave me seks të njëjta” është pika brenda Projektkodit Civil “për të cilën ka pasur keqkuptime dhe keqinterpretime”. Ai ka theksuar se të drejtat e njeriut janë të drejtat e të gjithë njerëzve dhe këtë e thotë edhe Kushtetuta e Kosovës si dhe praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ai ka theksuar që te “regjistrimi i bashkësive civile të personave me seks të njëjta”, në nenin 1138, është paraparë mundësia që këta persona të mund të regjistrohen si “bashkësi civile”.

“Kodi nuk i ka rregulluar kushtet dhe procedurën për këtë institucion të ri, por vetëm në mënyrë afirmative e ka përcaktuar që në të ardhmen do të rregullohet me ligj të veçantë. Pra, Kodi nuk është i mjaftueshëm. Kjo është në pajtim të plotë edhe me Kushtetutën, e cila nuk lejon asnjë lloj diskriminimi, përfshirë edhe diskriminimin në bazë të gjinisë. Po ashtu, më duhet të theksoj që Kodi nuk rregullon martesat ndërmjet personave me seks të njëjta. Kjo dallon me ‘bashkësinë e regjistruar civile’ ngaqë kjo e fundit mundëson vetëm bashkëjetesën dhe jo format e tjera të funksionit familjar”, ka thënë kryeministri Kurti.

agresive dhe unë do t’u përgjigjem disa komenteve specifike të ZPS-së”, ka thënë ai. Sipas tij, Haradinaj është shprehur qartë se të gjithë që kanë kryer krime duhet të ndiqen penalisht, pavarësisht se kush janë. “Kur ai u bë nënkryetar bashkë me Gucatin si kryetar, e bëri të qartë një gjë, ata persona që thirreshin nga ZPS duhet të bashkëpunonin, kjo ndryshoi pozicionin e mëparshëm që kishte OVL. Ata duhet të bashkëpunojnë sepse s’ka asgjë për të fshehur apo pasur frikë. Këtë ka thënë ai në deklaratën e tij”, ka thënë Cadman. I njëjti shtoi se kur Haradinaj bëri një fushatë që përmendi ZPS-ja kur mblodhi 150 mijë nënshkrime, ka nuk ishte për ta minuar

procesin e drejtësisë dhe të vërtetën, por se ka bërë peticion për t’ia paraqitur Kuvendit për ta menduar ligjin për DhSK-në. “Ishin hapa për të siguruar që Dhomat e Specializuara dhe ZPS-ja të bënin një proces të barabartë, dhe jo selektiv e diskriminues. Haradinaj ia ka dedikuar jetën e tij pavarësisht dhe integritetit të Kosovës dhe veprimet e tij duhet të shihen përmes kësaj thjerrëze, agresionin që e ka pësuar ai. Ka përgjegjësi të madhe trupi gjyqësor për të vendosur drejtësinë në këtë proces, dhe nuk ka të bëjë me rishkrimin e historisë, por të vendoset drejtësia dhe këtë kërkon Haradinaj”, ka thënë Cadman. Sipas tij, këto materiale nuk i ka

marrë Haradinaj, por kanë dalë nga ZPS-ja. Po sipas tij, Haradinaj ka deklaruar se të gjitha çështjet për të cilat është akuzuar janë çështje të interesit publik kombëtar. “Interesi publik është në favor të zotit Haradinaj dhe në mënyrë shumë të qartë”, ka deklaruar Cadman. Më tutje, ai tha se Haradinaj nuk është kundër drejtësisë dhe nuk është i vendosur për ta minuar këtë institucion dhe nuk është e vërtetë që ka përmendur emra të dëshmitarëve të mbrojtur. Avokati ka pohuar se inkurajon trupin gjyqësor që t’i trajtojë të gjitha provat në tërësi dhe jo në copëza të përzgjedhura.

Hysni Gucati së bashku me Nasim

Haradinaj po akuzohen për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, konkretisht për pengim të personave zyrtarë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, për frikësim të dëshmitarëve, për hakmarrje dhe për shkelje të fshehtësisë së procedurës. “Akuzat e paraqitura në aktakuzën e konfirmuar mbështeten në dyshimin e bazuar mirë se së paku midis 7 dhe 25 shtatorit 2020, z. Gucati dhe z. Haradinaj zbuluan pa autorizim informacion të mbrojtur prej Ligjit të Dhomave të Specializuara, ndër të cilat të dhëna identifikuese të disa dëshmitarëve (të mundshëm), në tri konferenca shtypi dhe aktivitete të tjera të transmetuara, si dhe përmes shpërndarjes së

mëtejshme ku përfshihen deklaratat në rrjetet sociale”, thuhej në njoftimin e Dhomave të Specializuara.

Gucati dhe Haradinaj ngarkohen se kanë bërë komente nënçmuese kundër dëshmitarëve të mundshëm dhe në mënyrë të përsëritur shprehen synimin e tyre për ta dëmtuar punën e Dhomave të Specializuara. “Me këto veprime, z. Gucati dhe z. Haradinaj shkelën fshehtësinë e procedurës dhe frikësuan dëshmitarë (të mundshëm) të Zyrës së Prokurorit të Specializuar dhe, si pasojë, penguan punën dhe hetimet e ZPS-së”, thuhej në njoftimin e Dhomave të Specializuara të Kosovës. (betimiperdrejtësi)

Komuna e Mitrovicës ndihmon 94 fermerë me motokultivator

MITROVICË, 16 MARS (ER) - Në sallën e Kuvendit të komunës së Mitrovicës është bërë nënshkrimi i kontratave me 94 përfituesit e motokultivatorëve, që në kuadër të subvencionimit në bujqësi, komuna e Mitrovicës, në bashkëpunim me organizatën "Islamic Relief", kanë mbështetur fermerët mitrovicas.

Të pranishëm në këtë ceremoni ishin drejtori për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Ferdi Kadriu, përfaqësues nga organizata "Islamic Relief", si dhe fermerët përfitues të këtij projekti. Në fjalën e tij, drejtori i DBZHR-së, Ferdi Kadriu, ka thënë se ndihet i lumtur që falë projektit të përbashkët me "Islamic Relief", është mundësuar mbështetja e 94

fermerëve të Mitrovicës, në mënyrë që bujqve tanë t'u ofrohen kushte sa më të mira të punës.

Drejtori Kadriu ka bërë me dije se kjo drejtori do të vazhdojë të mbështesë dhe do t'i rrisë investimet në sektorin e bujqësisë për t'i mbështetur fermerët përmes subvencioneve dhe granteve të ndryshme.




Policia u bënë thirrje pjesëmarrësve në trafik për kujdes

PRISHTINË, 16 MARS (ER) - Policia e Kosovës, bazuar në detyrat dhe autorizimet e saj ligjore dhe kushtetuese, është e përkushtuar për mbajtjen e rendit, garantimin e sigurisë publike si dhe menaxhimin dhe kontrollin e trafikut rrugor nëpër të gjitha rrugët e vendit. Policia e Kosovës, gjegjësisht Njësia për Kontrollin e Autostradave, e mbështetur nga njësitë e tjera të Divizionit të Komunikacionit Rrugor, në vazhdim të implementimit të planeve operative aktive si "Siguria në trafikun rrugor" dhe "Shtimi i masave të sigurisë në trafikun rrugor", gjatë një jave ka shqiptuar 1 380 gjoba për kundërvajtje të ndryshme në trafik, ka konfiskuar një automjet për ndalje të parregullt në autostradë, ka larguar nga trafiku gjashtë automjete të tjera, ka konfiskuar përkohësisht dhjetë

targa të automjeteve të paregjistruara, ka identifikuar pesë kundërvajtës duke drejtuar automjetet nën ndikimin e alkoolit si dhe 17 shoferëve u është shqiptuar masë mbrojtëse e ndalimit të drejtimit të automjetit nga tre muaj deri një vit.

Përveç aktivitetëve policore në këtë aspekt, Policia e Kosovës apelon te të gjithë pjesëmarrësit në trafik që të kenë kujdes më të shtuar, t'i respektojnë rregullat dhe shenjat e trafikut rrugor si dhe t'u përshtaten kushteve të rrugës për të pasur një siguri më të madhe në trafik.

Policia ka njoftuar se për të gjithë ata pjesëmarrës në trafik, në veçanti për shoferët e automjeteve, të cilët bëjnë shkelje të ligjeve dhe rregullave të trafikut, do të ndërmerren masa ndëshkuese sipas ligjeve në fuqi.



Kryetari i Gjilanit: Tërheqja e investimeve të huaja është synim yni gjatë mandatit qeverisës

GJILAN, 16 MARS (ER) - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka thënë se tërheqja e investimeve të huaja e projekteve ambicioze është synim kryesor gjatë mandatit qeverisës. Këto komente kryetari Hyseni i ka bërë pas takimit me përfaqësues të United Alsaqer Group. "Tërheqja e investimeve të huaja e projekteve ambicioze është synim yni gjatë mandatit tonë qeverisës. Gjilanin e

vizituan sot përfaqësues të United Alsaqer Group, kompani investimesh nga UAE, me të cilët biseduam mbi planet e komunës sonë si Zona Ekonomike apo investimet në fushën e turizmit dhe mundësitë e bashkëpunimit mes nesh. Iniciativat dhe investimet e ndryshme janë gjithmonë të mirëseardhura, në dobi të zhvillimit të Gjilanit", ka thënë kryetari i Gjilanit, Alban Hyseni.

Rama: Skena e pavarur e artit është çelësi i larmisë së një qyteti

PRISHTINË, 16 MARS (ER) - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka vizituar tri prej nismave 'bottom up' në artin pamor dhe muzikor. Ai ka thënë se

këto nisma do t'i mbështetin duke ofruar hapësirë pune dhe mbështetje programore. "Janë 'Fondacioni 17', 'Defy Them' dhe 'Studio për Artistë'. Këto nisma kreative, kaq

domethënëse për komunitetin artistik, synojnë të stimulojnë një skenë dinamike arti në Prishtinë. Kjo vizitë më frymëzoi që ta përkrahim edhe më tutje

zhvillimin e skenës së pavarur të artit, duke ofruar mbështetje të vazhdueshme për artistët. Këto celula kreative janë çelësi i një Prishtine dinamike", ka thënë Rama.



Vazhdon 'fshesa' e ministres Gërvalla

Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës ua ka ndërprerë marrëdhënien e punës 11 punonjësve në shërbimin e jashtëm. MPJD ka theksuar se ky vendim është marrë në vazhden e masave për vendosjen e ligjshmërisë në administratën publike të Kosovës dhe anulimit të vendimeve të jashtëligjshme të marra në të kaluarën



ambasadorëve të emëruar mbi baza politike përbëjnë vetëm një hap në reformën e thellë që do t'i bëhet shërbimit diplomatik të Kosovës. "Lirimi nga detyra dhe tërheqja e ambasadorëve të emëruar politikë është bërë në frymën e programit të miratuar qeveritar, i cili parasheh reformimin e shërbimit diplomatik të Republikës së Kosovës dhe respektimin e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Ligjit për shërbimin e jashtëm të Kosovës", ka thënë ajo përmes një deklarate për medie.

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 16 MARS - Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës ka njoftuar se pas një analize të hollësishme ligjore, të mërkurën ua ka ndërprerë marrëdhënien e punës 11 punonjësve të kësaj ministrie. "Ky vendim është marrë në vazhden e masave për vendosjen e ligjshmërisë në administratën publike të Kosovës dhe anulimit të vendimeve të jashtëligjshme të marra në të kaluarën. Personat e liruar sot nga detyra janë punësuar pa iu nënshtruar

procedurave të rregullta të pranimit në shërbimin e jashtëm, të përcaktuara me Ligjin për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës dhe as procedurave dhe rregullave të pranimit sipas Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i zbatueshëm në kohën kur këta persona janë emëruar në shërbimin e jashtëm. Ata kanë hyrë dhe janë konsideruar anëtarë të shërbimit të jashtëm përmes vendimeve arbitrare", ka njoftuar MPJD-ja.

Kjo ministri ka njoftuar se është duke shqyrtuar edhe masat që duhet të ndërmerren ndaj

zyrtarëve përgjegjës për punësimin e paligjshëm të personave të mësipërm. "Qeveria e Republikës së Kosovës mbetet e vendosur në zotimin e saj për vendosjen e ligjshmërisë në vend. Keqpërdorimi i parasë publike dhe punësimet e paligjshme nuk kanë vend në administratën

publike dhe do të ndalen dhe luftohen me vendosmëri", ka njoftuar Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ministria Gërvalla, sapo ka ardhur në krye të kësaj ministrie, ka shkarkuar edhe dymbëdhjetë ambasadorë. Ajo pati deklaruar se lirimet e fundit nga detyra e

Ish-ministri i Punëve të Jashtme, Enver Hoxhaj, propozimin e Qeverisë së Kosovës për lirim nga detyra të të gjithë ambasadorëve të Kosovës të emëruar politikë e ka konsideruar si suspendim të politikës së jashtme të Kosovës. Sipas tij, ky vendim përbën skandalin më të madh në politikën e jashtme.

Armë, municion dhe para konfiskohen në aksionin "Brezovica"

PRISHTINË, 16 MARS - Dy persona janë arrestuar dhe gjashtë të tjerë janë duke u intervistuar pas aksionit "Brezovica", me ç'rast janë bastisur shtatë lokacione të ndryshme në Shtërpcë, përfshirë edhe objektin e komunës të strukturave paralele të Serbisë në Shtërpcë.

Në këtë aksion është arrestuar kryetari i bordit të "Ski Center Brezovica" dhe një doganier, si të dyshuar për veprën penale "marrja e ryshfetit". "Gjatë zbatimit të kontrolleve të mëhershme janë gjetur dokumentacione që ndërlidhen me rastin 'Brezovica'. Pasi një nga të arrestuarit, ish-kryetari i komunës së Shtërpcës, Bratislav Nikoliq, është edhe koordinator i strukturave paralele, përkatësisht i komunës paralele serbe në Shtërpcë", ka thënë Rasim Maloku, prokuror në Departamentin e Krimeve të Rënda në Prokurorinë Themelore në Ferizaj.

Nga materialet e sekuestruara, tha ai, do të vërtetohet se a ka qenë lidhja funksionale mes dy komunave. Gjatë bastisjes, tha prokurori i rastit, janë konfiskuar para, armë, municion, laptop.

Ai nuk tregoi vlerën e parave apo sasinë e armëve.

Lidhur me këtë aksion ka reaguar drejtori i zyrës për Kosovën në



qeverinë serbe, Petar Petković, duke bërë me dije se Njësia Speciale e Policisë së Kosovës "ka hyrë në disa shtëpi serbe në komunën e Shtërpcës dhe se ka bllokuar punën e organeve të përkohshme serbe".

Ai e ka cilësuar këtë aksion si provokim.

Aksionet e koduara si "Brezovica"

kanë nisur qysh në fund të vitit të kaluar.

Në shënjestër të tyre janë personat e dyshuar për lëshimin e lejeve ndërtimore në Parkun Kombëtar "Shari" në zonën e Brezovicës.

Në fillim të muajit mars, në kuadër të këtyre aksioneve, janë arrestuar shtatë persona të dyshuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare,

marrje të ryshfetit dhe ushtrim të ndikimit.

Aksioni ishte zhvilluar në 12 lokacione të ndryshme në katër komuna të Kosovës, përkatësisht në Ferizaj, Prishtinë, Skenderaj dhe Lipjan, por nuk ka dhënë detaje se cilës komunë i përkasin personat e arrestuar.

Policia e Kosovës edhe në muajin

dhjetor të vitit 2021 dhe në muajin janar të këtij viti ka arrestuar persona të përfshirë në rastin e quajtur "Brezovica".

Në fund të dhjetorit janë arrestuar dhjetë persona, përfshirë ish-kryetarin e komunës së Shtërpcës, njëherësh zyrtarin e Listës Serbe, Bratislav Nikoliq, nën akuzat për keqpërdorim të pozitës zyrtare.

Mehaj fton qytetarët të kontribuojnë në Fondin për Siguri

PRISHTINË, 16 MARS (ER) - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka shprehur mirënjohje të lartë për të gjithë ata që po vazhdojnë pandërprerë të japin kontribut në Fondin e

Sigurisë. "Në emër të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të gjithë ushtarakëve të FSK-së ju shpreh mirënjohjen më të lartë për përgjigjen e jashtëzakonshme e të pritur, e cila po vazhdon

pandërprerë, me donacionet tuaja për Fondin e Sigurisë", ka shkruar Mehaj në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka ftuar qytetarët që të japin kontribut në Fondin e Sigurisë për ushtrinë.



Për dhe kundër tërheqjes së parave nga Trusti



PRISHTINË, 16 MARS - Ideja e tërheqjes së kursimeve pensionale nuk është e arsyeshme dhe dëmton kontributpaguesit, thotë për "Radion Evropa e Lirë" ish-ministri i Ekonomisë dhe Financave, Haki Shatri. Megjithatë, profesori i Ekonomisë, Muhamet Sadiku, mendon se tërheqja e kursimeve pensionale është një alternativë, e cila, sipas tij, mund ta zbusë gjendjen e rënduar ekonomike dhe sociale të qytetarëve.

Qytetarët në Kosovë janë goditur nga një rritje e lartë e çmimeve të konsumit.

Inflacioni në shkurt të këtij viti ka arritur në 7.5 për qind, krahasuar me 0.7 për qind sa ka qenë në shkurtin e 2021-shit.

Çmimet janë në trend të rritjes për shkak të krizës në tregje që ka shkaktuar pushtimi rus i Ukrainës.

Lufta në Ukrainë ka rritur në veçanti çmimet e energjisë, naftës dhe gazit.

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka propozuar tërheqjen deri në 30 për qind të kursimeve pensionale.

Deputeti i kësaj partie, Bekim Haxhiu, në emër të grupit parlamentar të PDK-së më 9 mars ka dorëzuar në Kuvend Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Fondin e Kursimeve Pensionale, i cili do ta mundësonte tërheqjen e këtyre mjeteve. Ky projektligj pritet t'i dërgohet kryesisë së Kuvendit për futje në rend dite për shqyrtim.

Sipas propozimit të PDK-së, kontributpaguesit që kanë më pak se 10 mijë euro kursime pensionale kërkohet që të kenë të drejtën e tërheqjes së 30 për qind të mjeteve. Ata që kanë deri 20 mijë euro - 25 për qind, nga 20 mijë deri 30 mijë - 20 për qind. Për kontributpaguesit që kanë kursime pensionale në shumën prej 30 mijë eurosh - 15 për qind dhe ata mbi 40 mijë euro - 10 për qind të shumës.

Një tërheqje e ngjashme deri në 10 për qind është bërë në vitin 2020, pas përkeqësimit të gjendjes financiare të familjeve për shkak të pandemisë së shkaktuar nga koronavirusi.

Partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje, është kundër një propozimi të tillë, ka konfirmuar për "Radion Evropa e Lirë" shefja e grupit parlamentar, Mimoza Kusari-Lila.

"Radio Evropa e Lirë" ka kontaktuar deputetë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, por ata nuk janë deklaruar rreth asaj se a janë për apo kundër këtij propozimi.

Tërheqja e 10-përqindëshit të kursimeve pensionale ishte bërë në kohën kur qeveria udhëhiqej nga kryeministri i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Avdullah Hoti.

Tërheqja e parave të kursimeve pensionale sa herë që ka probleme financiare në vend, për ish-ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Haki Shatri, është e paarsyeshme. "Nuk mendoj që është zgjidhje e mirë. Po ta marrim tani bazën

materiale të moshës së pensionit për shkak të disa krizave, për shkak të rritjes së çmimeve, nuk është e arsyeshme", thotë ai.

Ato para, të cilat mund t'i marrin kontributpaguesit, shton Shatri, nuk do ta zgjidhin e as nuk do ta zbusin problemin ekonomik e social të qytetarit.

Shatri shton se qeveria më mirë do të ishte të ndërhynte në politika të tjera si zbritja e akcizës dhe ulja e TVSh-së sesa ta prekte Fondin e Kursimeve Pensionale. "Trusti Pensional i ka të investuara mjetet dhe ato nuk mund të tërhiqen kur të dëshirojë dikush. Investimi i tyre ka obligime ligjore kontraktuese. Ka procedura, mund të jenë të investuara në periudha afatgjata. Trusti ka obligime edhe ndaj atyre që dalin në pension", thotë Shtari.

Profesori i Ekonomisë, Muhamet Sadiku, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se nga tërheqja e kursimeve pensionale nuk rrezikohet likuiditeti i sistemit financiar të Kosovës apo likuiditeti i Trustit. "Kosova ka mundësi të kufizuar buxhetore për të intervenuar, prandaj kërkohet intervenim nga burimet e tjera, siç janë edhe kursimet pensionale", thotë Sadiku.

Fondi i Kursimeve Pensionale me mbi 700 mijë kontributpagues ka vlerën mbi 2.3 miliardë eurosh. Aktualisht 78 për qind e mjeteve janë të investuara në tregjet financiare ndërkombëtare dhe rreth 22 për qind në Kosovë.

Zyrtarë të Fondit të Kursimeve Pensionale nuk kanë dashur të komentojnë lidhur me propozimin e tërheqjes së këtyre mjeteve.

Të pyetur nga "Radio Evropa e Lirë" se a preket likuiditeti i parave të Trustit në rast të tërheqjes deri në 30 për qind të kursimeve dhe se a duhet bërë një gjë e tillë, ata thonë se nuk mund të deklarohen për këtë. "Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës e ka për mandat t'i administrojë dhe menaxhojë kontributet pensionale deri në pensionimin e kontribuuesve.

Ky mandat nënkupton zbatimin e kornizës ligjore në fuqi, që buron nga institucionet përgjegjëse", thuhet në përgjigje.

Të gjithë të punësuarit në Kosovë paguajnë 10 për qind kontribute pensionale nga paga e tyre: 5 për qind i paguan punëdhënësi, kurse 5 për qind ndahen nga paga e të punësuarit.

Kursimet pensionale mund të përdoren nga kontribuuesi vetëm pasi t'i përmbushë kriteret për pensionim, përkatësisht moshën 65 vjeç.

Tërheqja e 10-përqindëshit

Kontributpaguesit, 10 për qind të shumës së siguruar nga kursimet pensionale, të fituar gjatë kohës sa kanë punuar, e kishin tërhequr në vitin 2020. Nga Trusti ishin tërhequr afro 200 milionë euro nga mbi 420 mijë kontributpagues. Tërheqja ishte bërë pas miratimit të Ligjit për Rimëkëmbjen Ekonomike.

Një raport i bërë nga Instituti për Hulumtime të Avancuara GAP pati vënë në pah se 40 për qind të mjeteve qytetarët i kishin deponuar në llogari private. "Një numër i madh i kontributpaguesve nuk i kanë shpenzuar mjetet, por kanë kursyer", thuhet në raportin e

GAP-it. Në këtë tërheqje, sipas ligjit, Qeveria e Kosovës do të kompensojë brenda pesë vjetëve vetëm kontributpaguesit që kishin kursime deri në 10 mijë euro dhe të cilët kanë bërë tërheqjen.

Kurse kontribuuesit që kishin më shumë se 10 mijë euro nuk kanë pasur kompensim. Fondi Monetar Ndërkombëtar në atë kohë e kishte kundërshtuar tërheqjen e 10 përqindëshit nga Trusti. Sipas FMN-së, tërheqja 'zvogëlon pensionet e ardhshme dhe kufizon madhësinë e tregut të brendshëm të kapitalit, që ka qenë burim esencial i financimit të buxhetit'.

Sa afër kolapsit është Rusia?



Nga Mary DEJEVSKY


Rusia është aktualisht po aq e izoluar nga bota sa ishte Bashkimi Sovjetik përpara se Mikail Gorbaçov të hidhte hapat e tij të parë drejt Glasnost-it më shumë se 40 vjet më parë. Gati i gjithë përparimi që kishte arritur Rusia post-sovjetike drejt shndërrimit në një vend "normal", është zhbërë brenda 2 javëve të fundit. Trashëgimia e supozuar e Vladimir Putin, e stabilitetit, parashikueshmërisë dhe standardeve shumë të përmirësuara të jetesës për shumicën e rusëve, po zhduket para syve të tyre. Ditët e fundit, Netflix dhe TikTok i janë bashkuar asaj që ishte tashmë një bojkot masiv i Perëndimit ndaj Ruisë. American Express ndoqi shembullin e kompanive Barclaycard dhe Mastercard me largimin nga tregu rus. Edhe rrjetet e mëdha të supermarketeve perëndimore, përfshirë Sainsbury's po braktisin Ruisinë. Po ashtu ka ndodhur me gjigantët e modës, Zara dhe Mango, apo edhe gjigantët suedez të mobiljeve, Ikea. Në Rusi janë mbyllur gati të gjitha mediat e pavarura të lajmeve. Është e ndaluar qasja në Twitter dhe Facebook. Mediat ndërkombëtare Deutsche Welle dhe Radio Liberty u bllokuan javën e kaluar. BBC ka rikthyer radion e saj të kohës së luftës dhe të Luftës së Ftohtë me valë të shkurtra, si mjet për të dërguar mesazhin e saj tek rusët. Transmetuesit e pavarur më të njohurit në Rusi, si stacioni radiofonik Moscow Echo dhe kanali televiziv TV Rain janë

mbyllur në kundërpërgjigje ndaj sanksioneve. Këtu përfshihen ligjet e reja që kriminalizojnë përhapjen e informacionit dhe që cilësohen të dëmshme për forcat e armatosura ruse, dhe ndalimin e përdorimit të termave si "pushtim" dhe "luftë". Rubla e ka humbur gjysmën e vlerës së saj, normat e interesit janë dyfishuar, ndërsa Bursa e Moskës është mbyllur që kur nisi aksioni ushtarak i Ruisë kundër Ukrainës. Ndërkohë, vazhdojnë protestat në rrugë kundër luftës, po ashtu edhe rrahjet dhe arrestimet. Më shumë se 4.300 njerëz u arrestuan vetëm të dielën, nga këta 1.700 vetëm në Moskë, sipas të dhënave zyrtare të Ministrisë së Brendshme. Grupet ruse të të drejtave të njeriut thonë se njerëzit u arrestuan në 53 qytete ruse, ndërsa numri i të arrestuarve që nga nisja e pushtimit është më shumë se 10.000. Ku do të çojë e gjitha kjo? Ka disa mënyra për të vlerësuar rëndësinë e asaj që po ndodh. Marrim për shembull protestat. Fakti që ka njerëz që vazhdojnë të protestojë, duke pasur parasysh rrezikun e arrestimit, dhe shtrirja e madhe gjeografike e demonstratave, për mua janë mbresëlënëse. Protestat politike në Rusi, prirën të përqendrohen në Moskë dhe Shën Petersburg. Sotprotestat kundër luftës po zhvillohen në qytete anembanë vendit, gjë që tregon se të paktën po depërtojnë deri tek qytetarët rusë disa informacione të padëshiruara për autoritetet. Mund të pritej që e gjithë protesta të ishte shtypur deri tani; por kjo nuk ka ndodhur. Por rusët pro-Kremlinit, madje edhe disa ukrainas, thonë se numri i

arrestimeve është i vogël në krahasim me madhësinë e Ruisë. "Mos i ikni së vërtetës!" - shkroi Katerina Kruk, menaxhere e Facebook në Ukrainë. "Rusët që e kundërshtojnë Putinin janë një pakicë absolute. Shumica ose e miraton ose e injoron në heshtje, ose ndoshta nuk e miraton, por jo aq fort sa të bëjë një veprim kundër regjimit" - thekson ajo. Kjo pikëpamje përforcohet edhe nga raportet se rusët po pajtohen në përgjithësi me versionin zyrtar - atë të një operacioni të kufizuar ushtarak kundër nazistëve - dhe po e mohojnë luftën që po zhvillon aktualisht Rusia në Ukrainë. Kundër këtij pretendimi ka dëshmi të kundërshtimit të luftës në disa qarqe elitare. Këtu përfshihen fëmijët e rritur të zyrtarëve të lartë rusë, disa figura publike të njohura dhe grupe profesionale, si mjekë dhe arkitektë, por edhe disa oligarkë, ndikimi i të cilëve është i konsiderueshëm. Po ashtu ka një kundërshtim edhe në DUMA, parlamentin rus, edhe pse në një numër të vogël. Disa analistë parashikojnë se herët a vonë do të ketë një rrënim të plotë të ekonomisë ruse, për shkak të kufizimeve të hapësirës manovruese të Bankës Qendrore të Ruisë dhe largimit në masë të kompanive të huaja. Radhë të mëdha janë krijuar para bankomateve në shumë zona të vendit. Sa mund ta tolerojnë izolimin rusët e rinj, që nuk janë të mësuar me privimet e dikurshme të baballarëve dhe gjyshërve të tyre? Diversiteti i mediave sociale, konsumizmi, dhe udhëtimet janë zhdukur pothuajse brenda natës.

Rusët më të moshuar kanë përjetuar shumë kriza, përfshirë edhe kolapse financiare, dhe janë më rezistencë në rrethana të tilla. Putin mund të përdorë edhe qasjen e "mbështetjes tek forcat tona" për t'iu kundërvënë "persekutimit" nga "armiqtë perëndimorë". Dhe falë sanksioneve të mëparshme, sidomos atyre të vendosura pas aneksimit të Krimesë nga Rusia në vitin 2014, ekonomia ruse është shumë më pak e varur nga importet sesa ishte më herët. Deri më tani, kam qenë e prirur të argumentoj, ashtu si shumë vëzhgues të tjerë të Ruisë, se kërcënimi më i madh për Putinin ka të ngjarë të vijë nga elita, dhe nga brenda mureve të Kremlinit, pasi anëtarët e rrethit të tij të ngushtë të shohin dëmin e madh që i ka shkaktuar Ruisë dhe interesave të saj kombëtare pushtimi i Ukrainës. Një lëvizje kundër Putinin mund të përshpejtohet nëse do të vërehet se lufta po shkon keq dhe se nëse shtohen më tej viktimat në radhët e ushtrisë ruse. Për momentin nuk ka raporte shumë të besueshme për të gjykuar se sa mirë apo keq po ecën Rusia, ndërsa nuk dihen objektivat dhe afatet kohore që ka vendosur Moskë. Perspektiva e një disfate në shkallë të plotë duket e pamundur, duke pasur parasysh epërsinë numerike të Ruisë. Por është e vështirë të shihet se si mund të quhet "sukses" pushtimi i një vendi të shkatërruar. Edhe protestat popullore, megjithëse mbresëlënëse, kanë qenë shumë të vogla dhe u shtypën shpejt, duke mos pasur deri më sot një ndikim domethënës. Por kjo mund të ndryshojë. Një

arsye është brishtësia e sistemit financiar rus. Rënia e rublës ka të ngjarë të pasohet nga një inflacion i madh. Edhe nëse kartat e parave të gatshme dhe ato të kreditit të lëshuara nga Rusia vazhdojnë të funksionojnë dhe nuk ka ende mungesë të elementeve bazë, si do të tolerohet mungesa e papritur e alternativave? Putin thotë se nuk ka ndërmend të vendosë ligjin ushtarak në vend, pavarësisht zërave që qarkulluan javën e kaluar. Por disa nga kufizimet mbi lirinë personale mund të fillojnë të çohen deri në ekstrem. Jo vetëm shtypja e protestave, por thuhet se njerëzit ndalohen në rrugët në Moskë dhe u kontrollohen telefonat e tyre për të parë nëse ka në to mesazhe opozitare, dhe për t'u bllokuar lajmet dhe mediat sociale. Të tilla masa funksionojnë si valvula sigurie për regjimin: Por çfarë do të ndodhë kur ato nuk jenë më? Dhe çfarë mund të ndodhë kur të mbyllen vendet e punës për shkak të largimit të kompanive të huaja? Apo kur të mbyllen dyqanet për shkak të rafteve bosh? Ka pasur raporte të izoluar mbi protestat e punëtorëve që nuk po paguhën për shkak të sanksioneve. Do të ishte e parakohshme që pushtimi në Ukrainë të cilësohet si një luftë e dështuar. Por në të kaluarën kriza ekonomike dhe pakënaqësia politike kanë rrëzuar regjime duke shkaktuar kaos. Dhe Revolucioni Bolshevik është një shembull klasik. Edhe pse kjo perspektivë mund të duket e largët, ia vlen gjithsesi që të kihet parasysh. / "The Spectator" - Bota.al



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Prishtina, Llapi dhe Drita kualifikohen në gjysmëfinale

Në gjysmëfinale janë Prishtina, Llapi dhe Drita të cilat i kanë eliminuar Ballkanin, Gjilanin dhe Ulpianën. Sot (e enjte) do të përballen Ramiz Sadiku - KEK-u

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 16 MARS - Tri skuadra e kanë siguruar kualifikimin në gjysmëfinale të Kupës, derisa skuadra e katërt e siguron sot (e enjte). FC Prishtina është skuadra e radhës që është kualifikuar në gjysmëfinale të Kupës së Kosovës në futboll. Kryeqytetasit e kanë mposhtur pas vazhdimëve skuadrën e Ballkanit me rezultat 1-2. Në minutën e 24-të pas një gabimi të portierit Stivi Frashëri përfitoi Qëndrim Zyba që realizoi për 0-1. Ballkani e gjeti golin e barazimit në minutën e 66-të me anë të Blend Baftiut, i cili shënoi me kokë pas një asistimi nga Armend Thaqi. Në dhjetë

minutat e fundit Ballkani luajti pa një lojtar, pasi u ndëshkua me karton të kuq Albin Rrahmani. Koha e rregullt përfundoi 1-1. Gjashtë minuta pas filluan vazhdimet, Besnik Krasniqi e kaloi Prishtinën në epërsi (1-2). Në minutat shtesë të ndeshjes gjyqtari Dardan Çaka shpërndau tre karton të kuq për Sulley, Solomon dhe Karabecin. Skuadra e Llapit është kualifikuar në gjysmëfinale të Kupës së Kosovës në futboll, pasi e mposhti Gjilanin me rezultat 2-0. Tahir Batatina, trajner i Llapit: "Mendoj se në këtë ndeshje, kemi dominuar ndaj Gjilanit në çdo aspekt, sidomos në pjesën e dytë me ndërrimet që i bëra. Kur i bëj ndërrimet edhe



Mourinhon ta shkatërroj si kundërshtar. Me Fazliun dhe Firminon e kam ditur se do ta dominoj dhe do ta fitoj ndeshjen. Llapi është më i përgatitur se të gjitha ekipet, ka potencial dhe mendoj se kupa sërish do të vijë në stadiumin 'Zahir Pajaziti'. Është një ndjenjë e veçantë që kaluam në gjysmëfinale të Kupës së Kosovës dhe në stadiumin tonë do të ketë gjithmonë spektakël dhe ndeshje të mira", ka thënë

Tahir Batatina, trajner i Llapit. Golat e fitores për skuadrën llapjane i realizuan Drilon Fazliu dhe Alef Firmino në minutat e fundit të takimit. Skuadra e Llapit është në rrugë të mirë për të mbrojtur titullin e Kupës, derisa Gjilanit i mbetet të luftojë për titullin e kampionit. "Me të thënë të drejtën ne e kishim kundërshtarin më të fortë të mundshëm, se ka ngec në pikë dhe kane ambicie Kupën, ka një skuadër të mirë. Jam i kënaqur

me ekipin. Ne kemi tentuar me i ndjekë të dy trofetë, tani nuk jemi më në Kupë, tani na mbetet vetëm kampionati dhe do të luftojmë fuqishëm për titullin kampion", ka thënë Ismet Munishi, trajner i Gjilanit. Ndërkohë, në gjysmëfinale është kualifikuar edhe skuadra e Dritës e cila e mposhti Ulpianën me rezultat 3-0. Golat e fitores për skuadrën gjilanasë i shënuan Fazliu, Azeraj dhe Krasniqi. Sot (e enjte) do të përcaktohet edhe gjysmëfinalisti i katërt, derisa përballen Ramiz Sadiku dhe KEK-u.

KUPA E KOSOVËS

Ballkani - Prishtina	1-2
Llapi - Gjilani	2-0
Drita - Ulpiana	3-0

Të enjten takohen:
Ramiz Sadiku - KEK-u

Gramoz Vokri deponon nënshkrimet në FFK: Besoj në fitore

PRISHTINË, 16 MARS (ER) - Gramoz Vokri të mërkurën në orën 11:00 ka deponuar nënshkrimet në Federatën e Futbollit të Kosovës. Djali i legjendës së futbollit dhe ish-kryetarit të FFK-së, Fadil Vokrit,

Gramozi, do të jetë kundërkandidat i kryetarit aktual Agim Ademi në zgjedhjet e 6 prillit. Vokri pas dorëzimit të nënshkrimeve është deklaruar për medie dhe ka shprehur optimizëm se do të arrijë të dalë

triumfues në këto zgjedhje. "E kemi një mbështetje goxha të madhe. Arsyeja se pse po kandidoj ka qenë mbështetja e klubeve të cilat nuk janë të kënaqura me zhvillimet brenda institucioneve. Po kërkohet një

frymë të re, që ta shtyjme futbollin përpara. Në futboll nuk hyn askush të humbë, shpresoj që gara të jetë korrekte dhe fer. Shpresoj që në fund të gjithë mund t'ia dalim", ka deklaruar Vokri.



Ademi: Nuk e sulmova Artan Govorin



PRISHTINË, 16 MARS (ER) - Kryetari aktual i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, ka mohuar se e ka sulmuar fizikisht drejtorin për marrëdhënie me jashtë, Artan Govorin. Në fakt, të mërkurën gjatë ditës është raportuar në medie se kandidati për kryetar të FFK-së e ka sulmuar Govorin, por këtë gjë e ka mohuar vetë Ademi, i cili nëpërmjet një postimi në profilin e vet në "Facebook" ka bërë me dije se

kjo është një e pavërtetë dhe se ka për qëllim dëmtimin e personalitetit të tij. "Sot mediet raportuan me ngut dhe me tituj bombastikë për, kinse, një eksces në FFK. Aty raportohet se unë, si president i FFK-së, kinse e paskam sulmuar fizikisht drejtorin për marrëdhënie me jashtë, Artan Govorin. Por, kjo është një tjetër e pavërtetë dhe një tjetër inskenim i atyre që po bëjnë në vazhdimësi shantazhe e gjëra të tilla me qëllim të

dëmtimit të imazhit tim dhe njëkohësisht të Federatës, por edhe të procesit zgjedhor në FFK. Nuk është aspak e vërtetë ajo që po aludohet për eksces dhe për asnjë prekje fizike, thjesht ishte një debat për punët e përditshme në federatë. Për këtë ka dëshmitarë brenda federatës", ka shkruar Ademi, i cili me këtë rast ka thënë se me inskenime të tilla nuk mund të ndërrohet vullneti i 44 delegatëve të

Kuvendit të FFK-së. "Të gjitha palët që dëshirojnë të përfitojnë nga inskenimet e tilla, ua bëj me dije se vullneti i 44 delegatëve të Kuvendit të FFK-së nuk mund të ndryshojë me presione dhe shantazhe dhe as me shpifje të tilla nga njerëz dhe grupe të interesit. Unë do ta vazhdoj punën time me ndershmëri dhe nuk do të lejoj të bie pre e shantazhuesve që për qëllim kanë kapjen e FFK-së", ka shtuar Ademi.

Drejtori Shala inspektoi punimet në stadiumin 'Liman Gegaj'

MALISHEVË, 16 MARS - Drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Fitim Shala, në kuadër të aktiviteteve të drejtorisë që e drejton, ka vizituar stadiumin e qytetit "Liman Gegaj" në Malishevë

me qëllim të njoftimit me punimet që janë duke u realizuar në stadiumin e qytetit, përkatësisht ndërtimin e tribunave dhe zhveshtoreve në stadium. Drejtori Shala ka kërkuar nga operatori që t'i

shtojë punimet për ndërtimin e zhveshtoreve dhe pjesës së tribunës me qëllim të krijimit të kushteve sa më të mira dhe sipas standardeve të kërkuara për zhvillimin e garave sportive. Stadiumi i qytetit

"Liman Gegaj" në Malishevë, krahas fushës së futbollit, i ka edhe stazat e atletikës, prandaj zgjerimi me tribuna, zhveshtoret dhe hapësira tjetër, janë të nevojshme në këtë stadium.



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Tap- Rrap" SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 71106381si dhe me nr. fiskal: 601177943 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Tap- Rrap" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 71106381 nr. fis: 601177943 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Tap- Rrap" L.L.C. has come to the decision to quit its business: 71106381 nr. fis: 601177943 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Lokali me qira

Lëshohet lokali me qira. Lokali ka 75 m2. Lokali gjendet tek "REB BULLI", në Prizren. Për informata mund të na kontaktoni në këta numra të telefonit: **044-514-373 dhe 044-199-707.**

RESTAURANT

SWISS

TAVERNATel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

L AJ MË R O J M Ë

Bashkëpronarët Shaqir Rasma, Dragoslav Petyroviq dhe Svetislav Petroviq, nga Fshat Mushnikovë Komuna Prizrenit, si **Blerësit potencial se, ne** Bashkëpronarët Novica Adxhellkoviq, Mlaxhan Fuksanoviq, Illij Mladenoviq, Stanislavka Mitroviq de Zivko Mlladenoviq, si bashkëpronarë ligjor të ngastrave kadastrale me numër **P-71611071-02837-1**, sipërfaqe të përgjithshme prej **351 m2**, në Zonën Kadastrale Mushnikovë, **po i SHESim - pjesët tona bashkëpronësore.**

Në këtë mënyrë i ofroj bashkëpronarëve, poqë se janë të interesuar për blerje, të më lajmërohen në afat prej 30 ditëve, në adresë: rr. " Fehmi LLadrovci " nr.70 – Prizren.

Një herri informoj se, e kam Blerësin potencial i cili brenda afatit prej 30 ditëve do ta paguan çmimin e përgjithshëm prej 5.000.00 € (Vpeseqind mijë euro) me para të gatshme-në kesh.

Telefoni kontaktues: +383 (0) 44-351-471

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Ajhan Isljami shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

▶ Naim Hoxha shpall te pavlefshme diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

▶ Besar Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

- Quality & Sales Award Recipients**
[Listed in alphabetical order]
- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
 - ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
 - ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
 - ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
 - ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
 - ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
 - ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
 - ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
 - ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
 - ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

